

Procesverbal

Konsultim publik : *Njësia Administrative Hudenisht*

Data : 18/10/2022

Ora : 10:00

Vendi: Fshati Hudenisht

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 37 persona të pranishëm (6 gra dhe 31 burra).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Paketa Fiskale dhe Buxheti 2023

Pjesëmarrës : Ilir Xhakolli (Kryetar i Bashkisë)

Irsa Karapanca (Drejtoreshë Financës)

Enjela Karafili (Drejtoreshë, Drejtorja e Tatimit dhe Taksave)

Shpresa Blaceri (Këshilltar, Bashkia e Pogradecit)

Drita Seitllari (Këshilltar, Bashkia e Pogradecit)

Jona Bojko (Sekretarja e Këshillit)

Matilda Tollaku (Sekretaria e Këshillit)

- Takimi drejtohet nga Kryetari i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :
- Sistemin e Ndrimit që po adaptohet në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec
- Sistemin e Furnizimit me ujë të pijshëm të gjitha fshatrave
- Sistemin e Kanalizimeve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën shprehën problematikat që ata kanë në fshatin ku jetojnë.

Klodian Selko: Lagjia e xhamisë në fshatin Hudënisht ka nevojë për ndicim, Rruga e Devanicës është terreni shumë keq, sa herë shtrohet me cakull prishet.

Lagjet lart në fshatin Hudënisht janë ca rrugica të vogla që duan investim.

Kryeplaku I fshatit Mëmlisht: Rruga kryesore e fshatit Mëmlisht është e amortizuar. Varezat kanë nevojë për pastrim . Lagjia në majë të fshatit janë 12 familje nuk kanë ujë. Përsa l përket pastrimit duhet të vijë më shpesh tek pjesa e shkollës dhe xhamisë.

Reis Dokollari: Rruga sipër është dëmtuar në Mëmlisht, rrugët nëpër arra janë me problem.

Syrja Bizgjoni:Në lagjen Pole në fshatin Hudënisht rruga është shumë keq, drita nuk ka, kanalet janë të papastruara.

Nexhipi: Në fshatin Mëmlisht nuk funksionon filtrimi dhe në momentin që bije shi uji turbullohet.

Gafur(Kryeplaku I fshatit Lin):Ndricimi në fshatin Lin është bërë shumë mirë, ndërsa ujesjellësi shumë keq. Me ndërhyrjen tonë bëmë të mundur ndërimin e tubave , sistemi vaditës është po shumë keq, bëmë kërkesë që të kishte disa cezma në fshat por nuk e morrën parasysh.

Ilir Xhakolli: Jemi në fazën e hartimit të projektit për ujrat e zeza që do të fillojë shumë shpejt. Do të rregullohen fasadat, rrugicat, Lini ka një perspektivë shumë të mirë, patjetër që do të marrë zhvillim.

Banori I fshatit Hudënisht: Ka vërejtje për ujin e pijshëm , kasetat janë jashtë funksionit.

Kryeplaku I fshatit Memlisht: Do të ishte mirë që në shkollat të kemi 2 cezma jashtë tek oborri I shkollës.

Banor I fshatit: Për invalidët nk njihet librezja e shëndetit në linjat e atobusëve për ulje të tarifës pasi ne na duhet të udhëtojmë shpesh për konsulta te mjeku.

Mbajtësi i procesverbalit

Jona Bojko